

Data 12.12.2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje Pajisje pune për shërbimet (Vula, dare vulosje, kuti postare)”

Fondi limit në tota: 10,509,133 (dhjetë milion e pesëqind e nëntë mijë e njëqind e tridhjetë e tre) Lekë, pa TVSH., vënë në dispozicion nga të ardhurat e vetë Shoqërisë “Posta Shqiptare” SH.A.,

Lloji i procedurës së prokurimit: “Procedurë e Hapur”.

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 35121500-3,Vula
44422000-4, Kuti Letra**

Specialist i Fushës, në zbatim të urdhërit “Për krijimin e njësisë së prokurimit, hartimit të specifikimeve teknike, kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe argumentimit të fondit limit”, për argumentimin e fondit limit j’u referua studimit të tregut, në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (i ndryshuar), nenit 76.

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim;
ose/dhe

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose më shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.
3. Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, titullari i autoritetit/entit kontraktor mund të caktojë struktura të posaçme. Në rast se nuk ngrihen struktura të posaçme, kjo detyrë i ngarkohet specialistit të fushës ose njësisë së prokurimit.

AFATI I DORËZIMIT TE MALLIT : do të jetë për 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e nenshkrimit te kontrates.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”,(i ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (ndryshuar) autoriteti/enti kontraktor **Posta Shqiptare sh.a.**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit.....

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron mesatare vjetore të realizuar për tre viteve te fundit 2021, 2022 dhe 2023, **ku në njerin nga këto tre vite të ketë realizuar një xhiro minimale vjetore me vlerë jo më të madhe se 40%** e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

(Kërkesa e lartpërmëndur do i shërbejë autoritetit kontraktor si tregues për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kjo në përputhje me nenin 77 te LPP dhe nenin 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”).

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/c, neni 43 si dhe pika 2, neni 55 e VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” (i ndryshuar), parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet, perkatesisht; Pika 2/c: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar . Duke qene se kjo procedure prokurimi eshte nën kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar ne eksperiencen e suksesshme te procedurave te zhvilluara me parë, rëndësisë së objektit të prokurimit, rëndësisë së Autoritetit Kontraktor, seriozitetit të marrëdhënieve kontraktuale me operatorë ekonomikë me aktivitet të vazhdueshëm në treg gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit te marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 ”Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

2.3Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë furnizime me natyrë të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit, me vlerë jo më të madhe se 40 % e vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak 40 % e vlerës së fondit limit të lotit përkatës/ shumatorës së loteve, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulët monetar. Vlera për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë: **ISO 14001:2015 mbi “Sistemet e Menaxhimit Mjedisor”** dhe **ISO 9001 – 2015 mbi “Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë”**, ose ekuivalente/të barazvlefshme, dhe objekti i saj të përputhet me mallrat e kërkuara .

Certifikata duhet të jetë e lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të

akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën. ISO 9001 përfaqëson standartin ndërkombëtar unanim i njohur si standarti që i përket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë. Ky standart aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit. Kjo certifikatë përfaqëson konfirmim zyrtar të një niveli me performancë të besueshme të biznesit si dhe provën e angazhimit për përmirësim të vazhdueshëm dhe plotësimin e kërkesave të klientit.) ISO 14001:2015 ose ekuivalente, ka të bëjë me manaxhimin mjedisor, i cili përfaqëson kalimin e drejtimit të kompanisë dhe respektimin e ligjeve, në një manaxhim të aktivitetit përkushtuar parandalimit të ndotjes dhe të përmirësimit të ndikimeve mjedisore. Referuar objektit të prokurimit, Njësia e Prokurimit gjykon se është e nevojshme që shoqëritë të jenë të certifikuara nga organizata ndërkombëtare të cilat garantojnë një nivel të pranuar të menaxhimit të mjedisit sa kohë që veprimtaria e tyre ka ndikim të drejtpërdrejtë mbi të. Dhe duhet të aplikojnë disa standarte sigurie lidhur me mbrojtjen e mjedisit, të cilat garantojnë nga certifikimi i tyre nga organizma ndërkombëta.

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar ku të përcaktohen edhe kontaktet e prodhuesit ose të distributorit të autorizuar. Në rast se do të paraqitet autorizim nga Distributori i Autorizuar duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, Website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se janë të autorizuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për tregtimin e mallit objekt prokurimi dhe ofrimin e shërbimeve lidhur me to brenda periudhës së garancisë. Në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor ka garanci që po hyn në marrëdhënie kontraktuale me një operator ekonomik serioz në treg, që ka autorizim për kryerjen e aktivitetit objekt prokurimi dhe siguron lidhjen përkatëse me subjektin që ka dhënë autorizimin.

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklaratën e garancisë për mallrat objekt prokurimi, në të cilën të jenë përcaktuar dhe përshkruar qartë të gjitha termat dhe kushtet e garancisë teknike që ai mbulon, si dhe periudha e garancisë teknike jo më pak se **24 (njëzet e katër)** muaj nga marrja në dorëzim e mallit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar, nenin 40, pika 3, 8 të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar, ku shprehet rrjedhimisht se *Autoriteti Kontraktor mund të hartojë kritere ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates, si dhe pika 8 e po ketij neni ne te cilen eshte percaktuar : Pika 8.Autoriteti/enti kontraktor ,pervec kerkesave te parashikuara ne kete nen ,mund te percaktoje kritere te vecanta ne varesi te objektit qe prokurohet,te cilat i vlereson te nevojshme per ekzekutimin me sukses te kontrates*

Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se malli i ofruar është cilësor dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Në cdo rast operatori ekonomik gjatë periudhës së garancisë duhet të mbajë përgjegjësi për mallin që ofron dhe se do t'i përgjigjet autoritetit kontraktor në rast se malli i furnizuar dëmtohet gjatë përdorimit për shkak të defekteve që vijnë si rrjedhojë e prodhimit apo instalimit të tij.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kataloget origjinale (ose kopje të noterizuar) përkates në gjuhën shqipe, ku të tregohen karakteristikat teknike të mallit të ofruar, origjinën e mallit të cilat duhet të permbushin specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga operatori ekonomik.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 6/b e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë që malli që ata disponojnë dhe tregtojnë është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentat e tenderit.

2.3.6. Në oren e përcaktuar në njoftimin e kontratës për hapjen e ofertave, operatorët ekonomik konkurent duhet të paraqesin dorazi, përpara Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO), **mostra (kampionë) të 1 (një) Vulë Datare** (vula datare metalike), **1 (një) Vula “U Pagua”**(vula shërbimi financiar), **1 (një) Vula “Tarifë e marrë”**(vula shërbimi postar), **1 (një) Dara Vulosje** dhe **1 (një) Kutit postare** të cilat duhet të jenë sipas të gjitha specifikimeve teknike të kërkuara. Mos paraqitja e këtyre mostrave (kampionëve) dhe jo sipas specifikimeve teknike është kusht për skualifikim.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 6/a nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se tonerat të jenë sipas kërkesave dhe në përmbushje të specifikimeve teknike

Specifikimet teknike fondi limit dhe kriteret e vecanta për kualifikim janë hartuar nga strukturë e posacme e ngritur me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor.

Njësia e Prokurimit: